



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

**Prishtinë, më 6 qershor 2022
Nr. ref.:RK 2003/22**

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI198/21

Parashtrues

Behlul Jashari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. AC-I-20-0265-A0001,
të 2 korrikut 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Behlul Jashari (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-20-0265-A0001] të 2 korrikut 2021 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së) për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), i cili i është dorëzuar më 7 korrik 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenet 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
7. Më 22 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
8. Më 12 maj 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Bazuar në shkesat e lëndës, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Ndërmarrjen Shoqërore/Gazetën "Rilindja" në periudhën nga shtatori 1973 deri në mars 2002.

10. Më 22 shkurt 2017, Autoriteti i Likuidimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) mori vendimin për fillimin e likuidimit të NSH-së Gazeta "Rilindja".
11. Parashtruesi i kërkesës inicioi dy procedura lidhur me këtë çështje, përkatësisht; 1) Më 12 dhe 21 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në AKP për kompensimin e 11 (njëmbëdhjetë) pagave të papaguara për periudhën nga maji 1998 deri në mars 1999 nga NSH Gazeta "Rilindja"; dhe 2) Më 3 prill 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në AKP që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës t'i paguhet kompensimi prej tri pagash të papaguara nga gazeta NSH "Rilindja". Prandaj, Gjykata do të paraqesë veçmas përmbledhjen e fakteve për këto dy procedura.

Procedura për kompensimin e 11 (njëmbëdhjetë) pagave të papaguara për periudhën kohore nga maji 1998 deri në mars 1999 e iniciuar në AKP, procedurë të cilën Gjykata e ka trajtuar në rastin KI162/21

12. Më 12 dhe 21 shkurt 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë në AKP për kompensimin e 11 (njëmbëdhjetë) pagave të papaguara për periudhën nga maji 1998 deri në mars 1999 nga NSH "Rilindja".
13. Më 10 maj 2017, AKP-ja, me Vendimin [PRN-142-0023], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ajo ishte parashkruar. Kjo procedurë ka kaluar nëpër të gjitha fazat e procedurës në DHPGJS, duke përfunduar me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nr. AC-I-20-0114-A0001 të 22 prillit 2021, përmes të cilit është vërtetuar vendimi i AKP-së.
14. Më 2 shtator 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën nr. KI162/21. Në atë kërkesë, parashtruesi kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit nr. AC-I-20-0114-A0001 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS në lidhje me 11 paga të papaguara nga periudha para privatizimit. Më 9 mars 2022, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Procedura lidhur me ushtrimin e të drejtës në tri paga për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në NSH gazeta "Rilindja" të iniciuar në AKP

15. Më 3 prill 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në AKP që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t'i paguhet kompensimi prej tri pagash të papaguara nga gazeta NSH "Rilindja".
16. Më 10 maj 2017, AKP-ja, me vendimin PRN142-0021, refuzoi kërkesën e parashtruesit për kompensim. AKP-ja arsyetoi se e ka refuzuar kërkesën si të pavlefshme, duke iu referuar nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04-L-034 për AKP-në dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, i cili është i zbatueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, i cili parasheh se „e drejta për të kërkuar pagesën e të ardhurave personale dhe të drejtave tjera të punësimit skadon pas 3 viteve”. AKP-ja gjithashtu theksoi se ankuesi nuk kishte

paraqitur asnjë dëshmi se kishte parashtruar ankesë apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të afatit të parashkrimit.

17. Më 5 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN142-0021. Në atë ankesë, parashtruesi i kërkesës thekson se pasi që nuk e ka pranuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kjo dëshmon se parashtruesit të kërkesës nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës derisa NSH të hyjë në likuidim. Parashtruesi i kërkesës citon nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, i cili përcakton të drejtat e punëtorëve në rast të largimit nga puna në një shkallë më të madhe.
18. Më 12 mars 2020, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-VI-17-0045, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se afati për paraqitjen e kërkesës për paga të papaguara në këtë rast kishte skaduar në mars të vitit 2005. Paditësi nuk e kishte dorëzuar më herët kërkesën në gjykatë apo para ndonjë autoriteti tjetër kompetent dhe afati i parashkrimit në këtë rast ka filluar të ecë në mars të vitit 2002. Në pajtim me nenin 608 të Ligjit për punën e bashkuar, afati i parashkrimit të kërkesave të tilla është 3 vjet, edhe pse sipas nenit 137 të LMD-së të vitit 1978, ky afat është 3 vjet. Pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi se ky afat është ndërprerë, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e refuzon kërkesën si të pabazuar dhe e vërteton në tërësi vendimin e AKP-së.
19. Më 12 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë ndaj Aktgjykimit (C-IV-17-0045) të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, përkatësisht nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, sepse ai ligj është ligj i përgjithshëm dhe është shfuqizuar me Ligjin për ndërmarrjet. Ankuesi thekson se procedura e likuidimit është e rregulluar me Ligjin për AKP-në si ligj i veçantë, i cili ka fuqi juridike më të lartë në krahasim me Ligjin për Punën e Bashkuar.
20. Më 2 korrik 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me Aktgjykimin AC-I-20-0265-A0001, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi në tërësi (Aktgjykimin C-IV-17-0045) e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.
21. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së në arsyetimin e këtij aktgjykimi theksoi se duhet të vlerësohen dëshmitë e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, „[...] Paditësi i referohet një njoftimi të AKP-së të datës 14 mars 2017 ku thuhet se: „përkundër faktit se ju më parë e keni njoftuar Agjencinë lidhur me pretendimin tuaj, ju përsëri duhet të parashtroni kërkesën lidhur me pretendimet tuaja, pasi që tani ka filluar procedura e likuidimit për këtë ndërmarrje”. Kolegji i Apelit e ka pasur parasysh këtë pretendim, por ka gjetur se në kohën kur ishte dërguar ky njoftim, tashmë kërkesa e tij ishte parashtruar ligjërisht, sepse nuk janë ofruar dëshmi që kjo kërkesë të jetë parashtruar brenda 3 vitesh nga dita kur pretendohet të ketë lindur detyrimi. Kjo kërkesë për herë të parë ishte parashtruar më 3 prill 2017 para AL të AKP-së në bazë të kërkesës para AL të AKP-së, mund të nxirret përfundimi se ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ndodhur në vitin 2008 (edhe pse nuk ka ndonjë vendim), kur NSH pushoi së ekzistuari. Para datës 03 prill 2017 nuk është provuar me asnjë provë nga

paditësi që ai ta ketë dorëzuar kërkesën para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent, në mënyrë që të pretendohet se është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit. Ankuesi pretendon se Shkalla e parë e DHPGJSK-së gabimisht e ka mbështetur aktgjykimin në dispozitën e nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, sepse ky ligj ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndërmarrjet. As ky pretendim ankimor nuk është i bazuar, për faktin se në aktgjykimin e ankimuar është thënë se këtë afat prej 3 vjetësh e parasheh edhe neni 137 i LMD-së i vitit 1978. Kjo do të thotë se Shkalla e parë e DHPGJSK-së e ka aplikuar LMD-në, ndërsa nenin 608 e përmend në aspektin komparativ. [...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kolegjet e DHPGJS-së i kanë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës dhe nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.
23. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson, „Konsiderojmë se është i pabazuar qëndrimi juridik i AKP-së se kërkesa e ankuesit është parashkruar. Procesi i likuidimit i N.Sh. "Rilindja" Gazeta (në likuidim) ka filluar me 22.02.2017. AKP-ja, në parashtrësën nr. 16082/2017 datë 14.03.2017, drejtuar OTHPB-së Gazeta "Rilindja" në përbërje të NIGRO në Prishtinë, ka pohuar se: "Përkundër faktit që Ju më parë keni njoftuar Agjencinë lidhur me pretendimin tuaj, Ju përsëri duhet të parashtroni kërkesën lidhur me pretendimin tuaj, pasi që tani kanë filluar procedurat e likuidimit për këtë ndërmarrje". Nga përmbajtja e kësaj parashtrëse rezulton se AKP-ja me kohë ka qenë e njoftuar me kërkesat tone, por megjithatë ka kërkuar që edhe njëherë të përsëriten brenda afatit të likuidimit. Duke iu përgjigjur shkresës, ankuesja ka parashtruar kërkesën brenda afatit për dorëzimin e kërkesave”.
24. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu deklaroi, „Në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për agjencinë Kosovare të mirëbesimit parasheh që tri pagat e papaguara të punonjësve janë kërkesa prioritare, dhe si të tilla kanë prioritet më të lartë, prandaj këto duhet paguar secilit punëtor”.
25. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi, „Sipas nenit 608 të LPB-së, lidhur me parashkrimin e kërkesës për pagesën e të ardhurave personale zbatohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave. Sipas rregullave të përgjithshme, neni 383 të LMD-së, parashkrimi nuk rrjedh gjatë gjithë kohës sa kreditori nuk ka pasur mundësi, për shkak të pagesave të pa përballueshme për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave rrugës gjyqësore. Fillimi i procedurës së likuidimit ndërpret parashkrimin, sepse vetëm me fillimin e procesit të likuidimit fillon rrjedha e afatit për parashtrimin e kërkesave, ndaj asnjë kërkesë e ankuesit nuk ka mundur të parashkruhet deri më 22.02.2017. Edhe ky fakt aktvendimin e ankimuar e bënë të paqëndrueshëm. Po ashtu, konsiderojmë se autoriteti i likuidimit nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të bazuar kur e ka vlerësuar të pavlefshme kërkesën e ankuesit. Nuk ishte kontestuese se kërkuesi ishte në marrëdhënie pune me N.Sh. nga viti Shtatori 1973 dhe për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk i është

lëshuar asnjë lloj vendimi as nuk është njoftuar lidhur me ndërprerjen e punës nga AKP-ja”.

26. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që ta obligojë AKP-në „që në emër të tri pagave bruto të papaguara për shkak të largimit nga puna ankuesit Behlul Jashari nga Prishtina lagjja Taslixhe 4 Rr. Fatmir Gjata p. nr. Kosovë t'i paguaj shumën 1.200 euro”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata gjithashtu i referohet më tej kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht u referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

30. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-20-0265-A0001], e Kolegjit të Apelit të 2 korrikut 2021, i cili i është dorëzuar atij më 7 korrik 2021 pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka parashtuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
31. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë, përkatësisht paragrafin (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “te shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungese të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, kur plotësohet njëri nga dy nën-kriteret, në vijim: a) kur parashtguesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës* (vendim) nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës* (vendim) nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtguesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës KI166/20,

parashtrues, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës*, kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).

33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 dhe 49 të Kushtetutës, nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së nga AKP-ja dhe kolegjet e DHPGJS-së. Prandaj, në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas të cilave, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

i. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

34. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e dispozitave të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

[...]

35. Përveç kësaj, Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, i cili parashikon:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij”.

36. Gjykata vëren se thelbi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë lidhet me konkluzionet e kolegjit të DHPGJS-së se kërkesa e tij për kompensimin e tri pagave për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në NSH “Rilindja” është parashkruar sipas nenit 137 të LMD-së dhe nenit 608 të LPB-së, parashtruesi konsideron se në rastin e tij AKP-ja dhe DHPGJS-ja është dashur ta zbatojnë nenin 383 të LMD-së.

37. Gjykata fillimisht rikujton se pretendimet në lidhje me parashkrimin ngrenë çështje sipas nenit 31 të Kushtetutës, përkatësisht siguria juridike në lidhje me

afatin, përkatësisht kufizimi i së drejtës për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave në gjykatë nga shkeljet e shkaktuara nga autoritetet publike punëdhënësit, etj.

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa e tij në AKP është parashtruar brenda afatit kohor dhe se afati i parashkrimit nuk ka skaduar, siç është përcaktuar nga AKP-ja dhe kolegjet e DHPGJS-së, duke shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë.
39. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykimit (C-VI-17-0045) të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, i cili thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka iniciuar procedurë për kompensim para vitit 2017, as në gjykatat e rregullta dhe as në ndonjë autoritet kompetent tjetër, dhe afati i parashkrimit në këtë rast filloi në mars të vitit 2002. Në pajtim me nenin 608 të Ligjit për punën e bashkuar, afati i parashkrimit të kërkesave të tilla është 3 vjet. edhe pse sipas nenit 137 të LPB-së të vitit 1978, kjo periudhë është 3 vjet. Pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi se ky afat është ndërprerë, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e refuzon kërkesën si të pabazuar dhe e vërteton në tërësi vendimin e AKP-së.
40. Gjykata më tej i referohet pjesëve përkatëse të aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, ku në lidhje me parashkrim arsyetoi: *„Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e paditësit nuk është e bazuar. Paditësi i referohet një njoftimi të AKP-së të datës 14 mars 2017 ku thuhet se: „përkundër faktit se ju më parë e keni njoftuar Agjencinë lidhur me pretendimin tuaj, ju përsëri duhet të parashtroni kërkesën lidhur me pretendimet tuaja, pasi që tani ka filluar procedura e likuidimit për këtë ndërmarrje“. Kolegji i Apelit e ka pasur parasysh këtë pretendim, por ka gjetur se në kohën kur ishte dërguar ky njoftim, tashmë kërkesa e tij ishte parashtruar ligjërisht, sepse nuk janë ofruar dëshmi që kjo kërkesë të jetë parashtruar brenda 3 vitesh nga dita kur pretendohet të ketë lindur detyrimi. Kjo kërkesë për herë të parë ishte parashtruar më 3 prill 2017 para AL të AKP-së në bazë të kërkesës para AL të AKP-së, mund të nxirret përfundimi se ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ndodhur në vitin 2008 (edhe pse nuk ka ndonjë vendim), kur NSH pushoi së ekzistuari. Para datës 03 prill 2017 nuk është provuar me asnjë provë nga paditësi që ai ta ketë dorëzuar kërkesën para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent, në mënyrë që të pretendohet se është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit”.*
41. Përveç kësaj, Kolegji i Apelit arsyetoi: *„Ankuesi pretendon se Shkalla e parë e DHPGJSK-së gabimisht e ka mbështetur aktgjykimin në dispozitën e nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, sepse ky ligj ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndërmarrjet. As ky pretendim ankimor nuk është i bazuar, për faktin se në aktgjykimin e ankimuar është thënë se këtë afat prej 3 vjetësh e parasheh edhe neni 137 i LMD-së i vitit 1978. Kjo do të thotë se Shkalla e parë e DHPGJSK-së e ka aplikuar LMD-në, ndërsa nenin 608 e përmend në aspektin komparativ”.*
42. Gjykata, në vazhdim, rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e saj, ku ishte theksuar se, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (Shih rastin e GJEDNJ-së,

Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës: KI68/21, parashtrues: *Leonard Matoshi*, aktvendim i 8 shtatorit 2021, paragrafi 49 dhe rastet e cituara aty). Në parim, një përjashtim i tillë ndërlihet me rastet të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës.

43. Gjykata, bazuar në një analizë të arsyetimit dhe konkluzioneve të AKP-së dhe kolegjeve të DHPGJS-së, konsideron se ato i kanë marrë parasysh dhe i kanë shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit në lidhje me parashkrimin, duke dhënë arsye të hollësishme për zbatimin e bazës ligjore (ligjit të aplikueshëm) në të cilin ata i bazuan konkluzionet e tyre për refuzimin e ankesave të parashtruesit të kërkesës për shkak të parashkrimit të së drejtës për të kërkuar tri paga për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në NSH Gazeta “Rilindja”.
44. Gjykata, duke analizuar arsyetimet e mësipërme, konstaton se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për cenimin e sigurisë juridike si pasojë e aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi arbitrare. Për më tepër, duke pasur parasysh tërë procedurën e zhvilluar para kolegjeve të DHPGJS-së, në rastin konkret nuk bëhet fjalë as për konkluzione arbitrare apo qartazi të paarsyeshme, sepse asnjë nga argumentet e dhëna në kërkesë nuk mbështet pretendimet se vendimi i AKP-së dhe aktgjykimet e kolegjeve të DHPGJS-së janë në kundërshtim me parimet e së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar vazhdimisht se kur pretendohen shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara mirë dhe argumente bindëse (shih, në këtë drejtim, rastin KI04/21, parashtruese: *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38-39, dhe rastet e cituara aty).
45. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se dispozitat e nenit 31 i Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe dispozitat e njëjta as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtruese: *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48, dhe rasti më i ri KI68/21, parashtrues: *Leonard Matoshi*, aktvendim i 8 shtatorit 2021, paragrafi 51).
46. Gjykata gjithashtu e konsideron të rëndësishme të përsërisë pikëpamjen e saj të përgjithshme se drejtësia që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 EKLJP-a të KEDNJ-së, nuk është drejtësi substanciale, por drejtësi procedurale. Në terma praktik, termi “*drejtësi procedurale*” do të thotë: (i) mundësi të procedurës kontradiktore; (ii) mundësia që palët në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesin pretendimet dhe provat të cilat i konsiderojnë si të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala

kundërshtare; dhe (iv) e drejta që argumentet e tyre të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen siç duhet nga gjykatat e rregullta (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së: *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rasti më i ri i Gjykatës: KI68/21, parashtrues: *Leonard Matoshi*, aktvendim i 8 shtatorit 2021, paragrafi 52 dhe rastet e cituara aty).

47. Në lidhje me këtë, Gjykata gjen se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë plotësuar të gjitha kushtet e mësipërme nga AKP-ja dhe kolegjet e DHPGJS-së, vendimmarrja e të cilave është plotësisht në pajtim me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së. Gjykata në këtë rast vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht nuk u pajtua me rezultatin e procedurës dhe gjykimin e rastit të tij në AKP dhe kolegjet e DHPGJS-së lidhur me çështjen e parashkrimit. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
48. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë bien në kategorinë e (iii), nën-kategorinë (b) të pretendimeve „të pambështetura apo të paarsyetuara“, dhe si të tilla, të njëjtat deklarohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

ii. Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së

49. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se në çfarë mënyre janë shkelur këto të drejta të garantuara me këto nene të Kushtetutës dhe KEDNJ-së në rastin e tij, por në kërkesën e tij ai vetëm i përmend këto nene.
50. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih rastet e Gjykatës KI163/18, parashtrues: *Kujtim Lleshi*, cituar më lart, paragrafi 85, dhe KI124/20, parashtrues: *Muhamed Ali Ceysülmedine*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42).
51. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së hyjnë në kategorinë (iii), nënkategoria (a) pretendime „të pambështetura apo të paarsyetuara“, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara, siç është përcaktuar me paragrafin (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

52. Si përmbledhje, Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha elaborimet dhe konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin që:
- i. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së hyjnë në kategorinë (iii), nënkategoria (b) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe si të tilla, në baza kushtetuese duhet të shpallen si qartazi të pabazuara;
 - ii. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, hyjnë në kategorinë (iii), nënkategoria (a) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe si të tilla, në baza kushtetuese duhet të shpallen si qartazi të pabazuara.
53. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe nenet 20 dhe 48 të Ligjit, si dhe paragrafin (1) (d) dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, më 12 maj 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani